



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 4
QERSHOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA ODRŽANE 4.
JUNA 2008. GODINE

Qershor – Juni
2008

R e n d i i d i t ë s

1. Shqyrtimi i parë i Grupit të katërt të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës,
- 1.2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës,
- 1.3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
- 1.4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së auditimit të Kosovës,
- 1.5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës.

D n e v n i r e d:

2. Prvo razmatranje četvrte Grupe nacrtà zakona iz Predloga Martti Ahtisaarija, po posebnom postupku:

- 1.1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o opštim izborima u Republici Kosova,
- 1.2. Prvo razmatranje Nacrt zakona o lokalnim izborima u Republici Kosova,
- 1.3. Prvo razmatranje Nacrt zakona o Centralnoj Banci Republike Kosova,
- 1.4. Prvo razmatranje Nacrt zakona o uspostavljanju Kancelarije Glavnog Revizora Kosova i Revizorske Kancelarije Kosova,
- 1.5. Prvo razmatranje Nacrt zakona o železnici Kosova.

A g e n d a:

1. First reading of the fourth Group of the Draft Laws from the Martti Ahtisaari's Proposal, based on the Special procedure:

- 1.1. First reading of the Draft Law on General Elections in the Republic of Kosovo,
- 1.2. First reading of the Draft Law on Local Elections in the Republic of Kosovo,
- 1.3. First reading of the Draft Law on the Central Bank of the Republic of Kosovo,
- 1.4. First reading of the Draft Law on Establishment of the Office of the Auditor General of Kosovo and the Audit Office of Kosovo,
- 1.5. First reading of the Draft Law on Railways in Kosovo.

Seanca filloi në orën 15: 00.

Seancën e drejtoi zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI: Lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre .

Ju njoftoj se në sallë janë 84 deputetë. Para se të kalojmë në rendin e ditës, kërkoj që me votim formal, Kuvendi të deklarohet me votën elektronike për Raportin e Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Shpresoj se jeni përgatitur.
Votojmë, tash.

Konstatoj se me 83 vota “për”, 1 “kundër” dhe 3 abstenime, miratohet raporti i Agjencionit Kosovar Kundër Korrupsionit për vitin 2007.

Në ndërkohë, në sallë janë 91 deputetë.

Të nderuar deputetë,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Mirë se keni ardhur në seancën plenare të Kuvendit të Kosovës.

Në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës për shmangien nga Rregullorja e Punës për shqyrtimin dhe miratimin e ligjeve të dedikuara në Propozimin Gjithëpërfshirës për zgjedhjen e statusit të Kosovës dhe legjislacionin e ndërlidhur me te, sipas procedurës së veçantë, të datës 15 shkurt 2008, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen mbajtur më 3 qershor 2008, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialin, u është shpërndarë deputetëve.
Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të datës 15. shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ta miratojmë Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, zotin Ramë Manaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

RAMË MANAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Deputetë dhe ministra të nderuar.

Unë, sot para jush paraqes Projektligjin për zgjedhjet e përgjithshme, projektligj ky i cili është sponsoruar nga Zyra e Kryeministrit. Ky projektligj ka për qëllim të rregullojë:

- Sistemin zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- financimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës;
- njohjen dhe mbrojtjen e të drejtës për të votuar, si dhe kriteret e pranushmërisë së votës;
- mirëmbajtjen e listave të votuesve;
- regjistrimin e partive politike dhe certifikimin e subjekteve politike;
- përgjegjësitë dhe funksionimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- krijimin dhe funksionimin e Komisionit Zgjedhor për Parashtresa dhe Ankesa;
- organizimin dhe funksionimin e komisioneve dhe këshillave të zgjedhjeve;
- rregullat për akreditimin e vëzhguesve të zgjedhjeve, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre;
- rregullimin e shpenzimeve për fushatë dhe obligimet për publikimet financiare;
- mbulimin e fushatave zgjedhore nga mediat;
- Kodin e Mirësjelljes së subjekteve politike, të kandidatëve të tyre dhe mbështetësve;
- procedurat e votimit, numërimit dhe shpalljes së rezultateve të zgjedhjeve;
- sanksionet dhe gjokat e ngarkuara për shkeljen e dispozitave të këtij ligji.

Çështja e sistemit zgjedhor është shqyrtuar në takimet e Presidentit me liderët e partive politike, në tri takime të njëpasnjëshme dhe në fund është arritur konsensus jo vetëm për sistemin, por edhe për disa çështje që unë do t'i prezantojë në vijim.

Pra, përveç sistemit proporcional është arritur konsensus që edhe më tutje në Kosovë të ketë një zonë të vetme zgjedhore. Siç e thashë sistemi i pastër proporcional, zgjedhjet të mbahen me lista të hapura, votuesi të votojë për subjektin politik dhe kjo votë i shkon me automatizëm liderit të subjektit politik dhe për një kandidat brenda këtij subjekti politik. Pra, votohet për subjektin politik që i shkon liderit dhe për një kandidat të vetëm, që është ndryshim me sistemin e deritanishëm kur është votuar deri në 10 kandidatë.

Mbetet pragu zgjedhor deri në 5%, dhe, natyrisht, mbetet kuota gjinore 30%.

Ka ende një dilemë që ka mbetur e hapur nëse duhet apo jo, që koalicionet parazgjedhore të kenë një prag më të lartë se sa 5%. Nuk ka propozime, por ka qenë pjesë e debatit, gjë që ka mbetur e hapur.

Më lejoni të theksoj se Projektligji përmban 20 kapituj, 129 nene dhe i plotëson të gjitha standardet për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, në bazë të votës së lirë të përgjithshme të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë. Është quajtur edhe Kod zgjedhor ose Kushtetutë zgjedhore. Projektligji, i cili del si obligim nga Propozimi Gjithëpërfshirës i Presidentit Ahtisari, është në pajtim të plotë me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nuk është në kolizion me ligjet tjera.

Ju lutemi që ta miratoni në parim këtë projektligj.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, zoti zëvendëskryeministër!

Sipas radhës, fjala është e kryetarëve të grupeve parlamentare, nëse ata donë ta marrin fjalën.

Në radhë është kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: I nderuar zoti Kryetar!

I respektuar zoti kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Duke pasur për bazë një çështje që është shumë përmbajtjesore, konsideroj marrëveshjen politike dhe pastaj inkuadrimin e kësaj marrëveshje në Ligj për zgjedhjet.

Ne si Grup Parlamentar e mbështesim këtë ligj në parim dhe ato vërejtje që i kemi do t'i paraqesim te Komisioni ad-hoc, që do të kryejë punë brenda ditës së sotme dhe ditës së nesërme.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, Zoti Kryetar i Kuvendit!

Zoti Kryeministër,

Anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë

Grupi Parlamentar i LDK-së, duke iu falënderuar lidhshiptit, Presidentit të vendit, i cili e ka edhe obligim kushtetues në atë që po presim të ndodhë ditëve të fundit dhe pas angazhimit të Kryeministrit dhe të zyrës së tij, është arritur që ky projektligj të vjen këtu.

Roli i Presidentit në arritjen e konsensusit ka qenë jashtëzakonisht i mirëpritur nga të gjithë ne dhe dëshirojmë edhe njëherë ta përmendim, jo vetëm si fakt po edhe si akt i cili kërkon angazhim, që në proceset e mëdha, që zakonisht në vendet tjera janë me tension, janë me konflikte politike dhe me vështirësi të mëdha, këtu u tregua një angazhim dhe proces i shkurtër i cili arriti ta sjell një konsensus.

Grupi ynë parlamentar e mbështet në parim këtë ligj. Grupi ynë parlamentar në dy nene, që sot po i përmendi jo rastësisht, neni 110 dhe 111 do të punojë për ta sqaruar, në mënyrë që Ligji të mos jetë i paqartë, të mos ketë dualizma, por ky sqarim që është kërkuar nga Grupi ynë Parlamentar, do të kërkojë precizim dhe sqarim të ligjit, në mënyrë që pas zgjedhjeve të mos ketë asnjë problem tjetër sa i përket mbarëvajtjeve dhe rezultatit zgjedhor.

Do të angazhohemi që gjatë ditës së sotme dhe nesër, vërtet, ta sjellim sa më shpejtë ligjin prapa për miratim dhe ky ligj në kuadër të legjislacionit që buron nga Pakoja e Presidentit Ahtisari, të miratohet.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Tani është radha e Grupit Parlamentar të AKR-së, shefi i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, Zoti Kryetar!

Zotëri kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë të nderuar,

Para vetës kemi një prej ligjeve më të rëndësishme, i cili besoj do të përcaktojë në masë të madhe edhe të ardhmen e vendit tonë Ligjin për zgjedhjet e përgjithshme.

Ky projektligj, për fat të keq nuk përmbush të priturat e qytetarëve të Kosovës, të cilët edhe deri tash nuk kanë qenë të kënaqur me sistemin zgjedhor në fuqi. Sikurse edhe dihet, pas shumë përpjekjeve ishte arritur që në zgjedhjet që i lamë pas, që listat e kandidatëve të jenë të hapura dhe ekzistonte një besim i plotë se për zgjedhjet e ardhshme Kosova do të ndahej në shumë zona, për të mundësuar kështu një garë ferr dhe të drejtë, ku votuesi do ta kishte mundësinë të votonte për kandidatin, i cili përpos që do të kishte në fokus interesin dhe nevojat e gjithë vendit, një vëmendje më të madhe do ta kishte ndaj votuesve të zonës së vet elektorale dhe llogaridhënia do të ishte shumë e afërt.

Ky ligj që po e trajtojmë sot, fatkeqësisht, jo që nuk përmban një nevojë të tillë, por, përkundrazi, tash mund të thuhet lirisht se kemi kthim prapa, jo vetëm për faktin se Kosova është një zonë e vetme elektorale, por pse ky ligj i ri i vë në pozita tërësisht të pabarabarta kandidatët me liderët e partive. Nuk besoj që ka një vend në botën demokratike, të cilit lideri i partisë nuk i nënshtrohet vullnetit të elektoratit. Kjo ndodh vetëm në Kosovë.

Vendimi që liderët partiakë i ka bashkuar pa hezitim, padyshim se do ta ngulfasë demokracinë e brendshme të partive politike dhe ato se në vend se të jenë parti të anëtarësisë tashmë po shndërrohen në parti të liderëve, të kontrolluara tërësisht nga ata, që edhe ashtu gjatë këtyre viteve kanë qenë qendër e vendimmarrjes në Kosovë. Jam shumë i befasuar me një pajtim të tillë të liderëve partiak, të cilët gojën e kanë plotë demokraci, ndërkaq veprimet e tyre janë tërësisht antidemokratike.

Po, pikërisht pse e kam lehtë dhe po flas dhe prandaj nuk jam përqendruar te liderët. Megjithatë do ta përfundoj se po e shohë se shumica prej nesh janë të pajtimit me një sistem zgjedhor të tillë, unë megjithatë po e them që me një sistem të tillë zgjedhor gjithsesi do të kemi demokraci të kontrolluar, jo nga Parlamenti, por nga udhëheqësit e partive dhe këtë lloj demokracie më së paku e meritojnë qytetarët e Kosovës, të cilët mendoj se kanë dhënë shumë për mposhtjen e monizmit dhe më së paku një formë të tillë dhe një qeverisje të tillë e meriton Kosova.

Grupi Parlamentar i AKR-së do të përpiket që brenda Komisionit ad-hoc të paraqesë këto vërejtje dhe pastaj do të shohim në procedim në shqyrtimin e dytë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, për kryetarin e Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, Zoti Kryetar !

Edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim këtë ligj. Ne e kemi dërguar një letër te institucionet përmes së cilës bashkërisht me grupet tjera opozitare, kërkojmë që të bëhen disa ndryshime te komisionet komunale zgjedhore dhe do të insistojmë që një çështje e tillë të merret parasysh në Komisionin ad-hoc, por ligjin në parim e votojmë.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë, kryetari Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, Kryetar!

Grupi Parlamentar i Lidhjes së Dardanisë e mbështet në parim këtë projektligj, duke e konsideruar jo vetëm një ligj me rëndësi të madhe që përcakton fatin e zhvillimit të proceseve demokratike në vend, mirëpo përcakton edhe në një masë të madhe sjelljen e qytetarëve të Kosovës në raport me votën e lirë.

Prandaj, duke e pasur në konsideratë se me këtë ligj apo me Ligjin për zgjedhjet, ne e japim edhe një porosi sa i përket standardeve demokratike, sa i përket transparencës në pajtim të plotë me kërkesën që e shprehu edhe Grupi Parlamentar i AAK-së, në mbështetje të plotë, sidomos në rregullimin e pjesës që ka të bëjë me Komisionin komunal zgjedhor dhe në vendvotimet, ne shpresojmë se do të jetë ligji final, i cili do të kalojë pas trajtimit që do t'i bëhet në Komisionin ad-hoc, do të jetë një ligj i cili do të shprehë në tërësi standardet demokratike dhe do të jetë një ligj që do të korrespondojë me transparencën dhe do të korrespondojë me nevojën që shtron procesi politik.

Ne kemi shumë vërejtje, sa i përket strukturës së brendshme të këtij ligji, duke parë që ka të bëjë me sjelljen e zyrtarëve publikë, që ka të bëjë me strukturën e brendshme, që ka të bëjë me vetë personat apo me grupet, të cilat nuk trajtohen në nivelin çfarë do të duhej të trajtohen, me aftësi të kufizuara, prandaj ne besojmë që pas trajtimit që do t'i bëhet ligji do të marrë miratimin e plotë nga ky Kuvend. Prandaj, në parim ne e mbështesim ndërsa vërejtjet tona do t'i adresojmë në Komisionin ad-hoc.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar "7+". Fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, predsedavajući!

Parlamentarna Grupa "7+", u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i smatra da je uradjen po visokim standardima, mada imamo neke primedbe koje čemo dati kroz ad-hoc Komisiju. Ovde želimo samo da napomenemo član 61.3 e, poziva se na član 66.3 d, koji uopšte ne postoji, znači to je ono što smo приметили. Takodje, mora dobro da se preciziraju članovi 110,4, 110,5 i 111,2a, koji su zaista nezgrapni i koji mogu stvarati zabunu sutra prilikom rada komisija.

Ja çu samo proçitati çlan 111,2a, koji govori o pragu, izbornom pragu, odnosno cenzusu koji teško može razumeti dobar bravnik, a kamo li neko ko je u toj materiji početak. Govori se o sto mesta u Parlamentu koji treba da se rasporedi izmedju političkih subjekata i kaže:“ Izmedju 100 mesta će biti rasporedjena izmedju političkih subjekata koji predstavljaju zajednicu kosovskih Srba, i nevećinskih zajednica i izmedju političkih subjekata koji ne predstavljaju kosovske Srbe ili nevećinske zajednice, a koji su dobili najmanje 5% od ukupnih validnih glasova na izborima za Skupštinu“. Zaista jedna nezgrapna formulacija i ako je prvnika, možda se naslutiti da se odnosi da ove, ostale zajednice odnosno zajednice Srba i drugih zajednica neće imati taj prag, odnosno cenzus a da će zajednice, odnosno partije i politički subjekti koji predstavljaju većinsku zajednicu, da će imati taj prag od 5%, ali prema ovome veoma teško se može zaključiti kako je data ova formulacija.

Zahtevamo da se u ad-hoc Komisiji, koliko je to moguće u ovih 20 narednih sati da se to precizira, još neka druga mesta, inače u načelu naša Parlamentarna grupa podržava ovaj Nacrt Zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të SLS-së, fjalën e ka deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Ju faleminderit!

Poštovani predsedniče,

Uvaženi premijeru, zamenici premijera, ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Poslanička grupa SLS će u načelu podržati ovaj Zakon. Eventualne primdke će uložiti kroz amandmane Ad-hoc komisiji, i svakako želim da se zahvalim zameniku premijera na iscrpnoj prezentaciji, koja je zaista više nego korektna. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit! Sipas mocionit, radha është për t'u përgatitur për votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash.

Konstatohet se me 76 vota “për”, 5 “kundër”, 7 abstencione, miratohet në parim Projektligji për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15. shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t'ia paraqesë Kuvendit Raportin me rekomandime.

Në radhë është shqyrtimi i parë i Projektligjit për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit, të datës 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim. Ftoj përfaqësuesit e Qeverisë, ministrin, zotin Sadri Ferati, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

SADRI FERATI, MINISTËR: Ju faleminderit!

I nderuari Kryetar i Kuvendit,

I nderuari Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra

Të nderuar deputetë,

Siç dihet , aktualisht, në Kosovë nuk ka ligj të veçantë për zgjedhjet lokale. Deri më tani kjo fushë ka qenë e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut, 2007/27 për zgjedhjet komunale.

Projektligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës, do të jetë akt bazë për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve lokale të drejtpërdrejta për këshilltarët e kuvendeve komunale dhe kryetarët e komunave.

Konkretisht Ligji për zgjedhjet lokale përmban gjithsej 31 nene dhe është i ndarë në 19 kapituj.

Secila komunë konsiderohet zonë e vetme zgjedhore. Numri i këshilltarëve të kuvendeve komunale është përcaktuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale, neni 36 sipas numrit të qytetarëve nëpër komuna. Kryetari i komunës zgjidhet drejtpërdrejt nga vota e qytetarëve. Përveç kushteve tjera të përgjithshme, ai duhet të jetë banor i komunës së paku 3 vjet. Nëse në rundin e parë nuk fiton asnjëri nga kandidatët 50% plus 1 votë, shkohet me balotazh. Kandidati i cili fiton shumicën e votave në rrethin e dytë, zgjidhet kryetar i komunës.

Kryetari i komunës dhe këshilltarët e kuvendit komunal, nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë tjerë të asnjë organi tjetër të zgjedhur. Nëse përfundohet mandati i kryetarit sipas kushteve të parapara me ligj, ai zëvendësohet përmes zgjedhjeve të jashtëzakonshme sipas procedurave të cekurave më lartë.

Duke u bazuar në atë që u tha më lartë, konsiderojmë se Projektligji i përmbush të gjitha kriteret demokratike që parashihen edhe me konventa ndërkombëtare dhe propozojmë Kuvendit që ta miratojë..

KRYETARI: Ju faleminderit, Zoti Ministër!

Radha është e Grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, për kryetarin e Grupit, zotin Ramë Buja.

RAMË BUJA: Edhe këtë projektligj ne si Grup Parlamentar e kemi lexuar, e kemi realizuar, por nuk e kemi debatuar. Këtë do ta shfrytëzojmë që sot ta bëjmë gjatë ditës dhe vërejtjet eventuale t'i bëjmë në Grupin ad-hoc, kështu që në parim e miratojmë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, e kryetarit të Grupit, Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Kryeministër,

Faleminderit ministër, Ferati.

Ligji për zgjedhjet lokale i paraqitur sot, e ka mbështetjen e grupit tonë Parlamentar. Ne në Komisionin ad-hoc do ta japim kontributin tonë. Mendojmë që te e drejta e votuesit për t'i zgjedhur këshilltarët komunal, duhet të jetë formula e njëjtë me nivelin nacional, me nivelin parlamentar, por kjo është çështje e Komisionit ad-hoc.

Edhe një herë japim mbështetje këtij projektligji.
Ju faleminderit shumë.

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së. Fjalën e ka kryetari i Grupit, Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Edhe Grupi Parlamentar i AKR-së, i jap mbështetje këtij projektligji, natyrisht, por në disa pjesë mund dhe duhet të ndërhyhet gjatë punës në Komisionit ad-hoc.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit shumë!
Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetarit të Grupit, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, Zoti Kryetar! Ashtu, sikurse për ligjin paraprak, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim këtë ligj. Të gjitha provizionet, të cilat do të varen nga ligji paraprak do të kërkojmë të vlejné edhe në këtë ligj.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar të LDD-së. E ka fjalën kryetari i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit!
Grupi Parlamentar i LDD-së e mbështet në parim këtë projektligj, duke konsideruar se të gjitha ato të cilat i cekëm edhe gjatë projektligjit tjetër, që e miratuam, do të vlejné edhe për këtë projektligj. Sa i përket strukturës së brendshme të këtij projektligji shumëçka duhet të harmonizohet, sidomos të parashihet një vërejtje konkrete, normat për

regjistrimin e subjekteve politike, të cilat nuk janë të adresuar përmes këtij ligji. Pastaj, shumëçka që ka të bëjmë dhe të përcaktohet me shërbimet tjera të votimit, të cilat duhet të kyçen për strukturat apo organizimet e veçanta si TMK-ja, SHPK-ja, e shumë të tjera, duhet të precizohen, si dhe kur duhet të votojnë këto struktura dhe pastaj ka të bëjë më renditjen, e cila nuk përkojnë me kërkesën. Të gjitha këto ne do t'i adresojmë në Grupin ad-hoc, ndërsa në parim e përkrahim.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Radha është e Grupit Parlamentar” 7+”, fjalën e ka deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, presedniçe!

I parlamentarna grupa “7+”, u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i pridružuje se mišljenju da članovi ovog zakona moraju biti usaglašeni sa Nacrtom zakona o opštim izborima. Posebno je primetno ovde da se predlaže da birači mogu glasati za najviše 10 kandidata, a ovamo smo imali za jednog kandidata. Mislim da će, ako budu istovremeni izbori, to stvarati zabunu.

Mora se ovo saglasiti. Ako se na opštim izborima glasa za jednog kandidata, sa liste na lokalnim izborima glasa za 10. mislim da to nije dobro i još neke druge stvari koje treba usaglasiti.

U načelu podržavamo ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është fjala për Grupin Parlamentar të SLS-së.
Fjalën e ka deputeti Slobodan Petroviq.

SLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se!

I Poslanička grupa SLS, u načelu podržava ovaj Zakon i koristimo priliku da eventualne primedbe predložimo u amandmanima u Ad-hoc komisiji. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim dhe votoj tash:

Ju njoftoj se në sallë janë 91 deputetë.

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenim, miratohet në parim, Projektligji për zgjedhjet lokale në Republikën e Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës të datës 15 shkurt 2008 ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës

Në bazë të vendimit të Kuvendit të Kosovës datë 15 shkurt 2008 janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë, para deputetëve, ta prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari, Zoti Kryetar,

I nderuari Zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra.

Mirdita dhe përshëndetje të gjithëve.

Projektligji për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës është projektligj organik dhe shumë i rëndësishëm, sidomos tani me transferin e kompetencave në sektorin, mbase, më të ndejshëm, i cili rregullon sistemin bankar dhe atë të institucioneve të sigurimit.

Ky projektligj është i miratuar në Grupin Gjithëpërfshirës , në atë strategjik dhe në Qeverinë e Kosovës.

Kjo lëmi deri më tani është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2006/47 për Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës.

Me këtë projektligj krijohet Banka Qendrore e Republikës së Kosovës e cila është pasardhëse e Autoritetit të Bankave dhe Pagesave të Kosovës dhe Autoritetit Qendror Bankar të Kosovës.

Në bazë të dispozitave të këtij ligji, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është subjekt i pavarur juridik me kompetenca të plota.

Banka Qendrore e Kosovës, si organ i pavarur publik do të gëzojë autonomi operacionale dhe administrative dhe do të funksionojë jashtë kornizës së strukturave qeveritare të Kosovës dhe Shërbimit Civil të Kosovës, ashtu siç është e rregulluar në shumicën e shteteve moderne.

Objektivat kryesore të Bankës Qendrore të Kosovës janë: nxitja e sigurisë, aftësisë se pagimit dhe funksionimit efikas të sistemit financiar, stabil dhe të bazuar në ekonominë e tregut, duke inkurajuar daljen e instrumenteve financiare të sigurta për treg, si dhe t'i mbështesë politikat e përgjithshme të ekonomisë së Kosovës.

Banka Qendrore e Kosovës do ta informojë dhe do të bashkëpunojë me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, me Qeverinë e Kosovës dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës në përmbushjen e objektivave lidhur me pagesat, veprimet bankare dhe çështjet tjera financiare.

Kapitali i autorizuar i Bankës Qendrore do të jetë 30 milion euro, deri më tani ishte 20. Banka Qendrore e Kosovës do të ketë Bordin drejtues, menaxhmentin dhe stafin. Bordi drejtues i Bankës Qendrore të Kosovës do t'i krijojë politikat për punën e Bankës Qendrore të Kosovës do të mbikëqyrë zbatimet e tyre.

Bordi drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, 4 drejtorë jo ekzekutiv dhe guvernatori. Drejtori i Thesarit, i cili është në kudër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, është një nga drejtorët jo ekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës. 3 drejtorët tjerë jo ekzekutiv, duke përfshirë edhe guvernatorin nominohen nga Bordi drejtues ku dërgohen për miratim në Kuvendin e Kosovës, ku pas marrjes së miratimit, dërgohen për emërim te Presidenti i Republikës së Kosovës.

Mandati i çdo anëtari të Bordit drejtues është 5 vjet. Banka Qendrore e Kosovës është i vetëm organ përgjegjës për licencimin e institucioneve financiare, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre.

Banka Qendrore e Kosovës për zbatim të këtij ligji nxjerr edhe akte të tjera nënligjore.

Ky projektligj ka 70 nene. Projektligji ka zotimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit buxhetor në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si i tillë kërkoj dhe propozoj që të miratohet nga ju deputetë të nderuar.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Radha është e shfave të grupeve parlamentare. Sipas radhës kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, nëse nuk ke s'je i obliguar ta marrësh fjalën. Grupi Parlamentar i LDK-së në rregull është. Atëherë, fjalën ia kalojmë Grupit Parlamentar Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Fjalën e ka kërkuar Besa Gaxherri, në emër të kryetarit të Grupit!

BESA GAXHERRI: Okej, faleminderit, zoti Kryetar!

Edhe pse s'e mori asnjë grup parlamentar fjalën, nuk mendoj se ky ligj është krejt i parëndësishëm për të mos e dhënë mendimin. Megjithatë, pra duke pas parasysh që vërtetë ky ligj është i rëndësishëm së veçanti për çdo shtet në veçanti për shtetin e Kosovës që është i ri dhe ka problemet e mëdha ekonomike e në veçanti në sistemin bankar, Lidhja Demokratike e Dardanisë, natyrisht, që i jep përkrahje në leximin e parë, përveç vërejtjes që e kisha thënë për momentin që Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk ka pasur mundësinë sipas shkresës saj të paraqet deklaratën për implikimet buxhetore të këtij ligji që mendoj se është dashur të jetë, mundësisht thotë brenda 60 dhe jo më vonë 180 ditë nga data e miratimit të këtij projektligjit do të na ofrojë këtë deklaratë. Megjithatë, vërejtjet tjera ne do të angazhohemi t'i paraqesim në Komisionin ad-hoc.

Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Mirë.

Atëherë, kalojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash: Lexoni mocionin, ju lutem

Konstatohet se me 76 vota "për", 4 "kundër" dhe 2 abstenime, miratohet Projektligji i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Edhe një herë vlen për të gjithë deputetët le ta lexojnë mocionin e miratuar në këtë Kuvend më datë 15 shkurt 2008.

Në bazë të vendimit të Kuvendit datë 15 shkurt 2008 ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e ardhshme t'ia paraqes Kuvendit raportin me rekomandime.

Ju faleminderit!

Pika e katërt e rendit të ditës është:

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës**

Në bazë të vendimit të Kuvendit datë 15 shkurt 2008, janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Ahmet Shala, që në emër të Qeverisë para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari, Zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuari zoti Kryeministër,

Të nderuar deputetë.

Projektligji për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit është projektligj që ndërlidhet me statusin final të Kosovës për bartjen e kompetencave nga institucionet ndërkombëtare në ato vendore.

Ky projektligj është miratuar në Grupin punues gjithëpërfshirës dhe në atë strategjik, si dhe në mbledhjen e Qeverisë të Republikës Kosovës.

Deri tani kjo fushë është rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut 2002/18 për themelimin e Zyrës së Revizorit të Përgjithshëm të Zyrës së Revizionit të Kosovës.

Dispozitat e këtij projektligji promovojnë standarde më të larta të transparencës, përgjegjësisë dhe ndershmërisë në menaxhimin financiar dhe mbarëvajtjen e administratës publike të Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm do t'i kryejë detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe nuk i nënshtrohet urdhrat ose kontrollit të cilido person ose institucion tjetër, ka liri të plotë në veprimin dhe ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të tij.

Auditori i Përgjithshëm i Kosovës emërohet dhe i raporton Kuvendit të Kosovës, ai raporton, emërohet me mandat 5 vjeçar dhe duhet të jetë një person me kualitete të larta profesionale, morale dhe me një përvojë 10 vjeçare në fushën e financave publike.

Auditori i Përgjithshëm kryen në baza vjetore auditime të rregullsisë së buxhetit të konsoliduar të Kosovës, organizatave buxhetore, organeve të pavarura dhe subjekteve të tjera të cilat janë më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga fondi i Konsoliduar i Kosovës.

Auditori i Përgjithshëm i publikon me shkrim standardet e auditimit të sektorit publik të cilat duhet të respektohen nga personat që kryejnë auditimet e rregullsisë dhe të mbarëvajtjes.

Auditori i Përgjithshëm duhet t'i raportojë Kuvendit për të gjitha auditimet e rregullsisë dhe në këtë kontest do t'i zbatojë kërkesat dhe procedurat e parapara me këtë ligj.

Auditori i Përgjithshëm i siguron një raport Kuvendit për auditimin e rregullsisë së buxhetit të konsoliduar të Kosovës dhe të çdo institucioni apo subjektit të referuar në nenin 3.2, jo më vonë se deri më 31 gusht të vitit pas periudhës së kontrollit.

Kopjet e raportit të auditimit të Auditorit të Përgjithshëm do të vendosen në dispozicion publik.

Në afat prej 30 ditësh pas publikimit të raportit, institucioni i auditimit duhet t'i dorëzojë Auditorit të Përgjithshëm një raport i cili përcakton masat që ka për qëllim të ndërmarrë për zbatimin e rekomandimeve. Pra, secili agjencion buxhetor brenda 30 dite duhet të përgatisë një plan aksional për këshillat dhe rekomandimet e auditorit.

Përveç auditimeve të rregullta, Auditori i Përgjithshëm me kërkesë të Qeverisë apo Kuvendit, kryen edhe auditimet e rregullsisë financiare ose auditimet të mbarëvajtjes në cilindo institucion apo subjekt në përputhje me nenin 3 paragrafi 2 i këtij ligji.

Me dispozitat e këtij ligji themelohet edhe Zyra e Auditimit të Kosovës e cila përbëhet nga Auditori i Përgjithshëm dhe personeli i Zyrës së Auditimit.

Auditori i Përgjithshëm mund të emërojë më së shumti 2 zëvendësauditorë të përgjithshëm.

Funksion i Zyrës së Auditimit është që t'i ndihmojë auditorin e përgjithshëm të kryejë funksionin e tij konform ligjit.

Auditori i Përgjithshëm është i autorizuar që të nxjerrë akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

Ky projektligj ka 9 nene dhe ka zotimin e Ministrisë së Ekonomisë së Financave për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit buxhetor në buxhetin e konsoliduar të Kosovës, sikurse edhe ligji paraprak në afatin e kërkuar ligjor.

Kërkoj dhe propozoj nga ju, të nderuar deputetë, që të miratohet ky ligj sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Kërkoj nga administrata e Kuvendit që në kutitë e deputetëve edhe një herë ta shumëzojë ose t'u dërgojë vendimin e datës 15 shkurt 2008.

Kryetarët e grupeve nuk janë paraqitur për diskutim.

Lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 81 vota “për”, 2 “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet Projektligji për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës.

Në bazë të vendimit të Kuvendit datë 15 shkurt 2008 ngarkohet Komisioni ad-hoc që për seancën e radhës t'ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Në radhë kemi pikën e pestë të rendit të ditës.

- Shqyrtimi i Projektligjit për hekurudhat e Kosovës

Në bazë të vendimit të Kuvendit datë 15 shkurtë 2008 janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj përfaqësuesin e Qeverisë, ministrin Fatmir Limaj, që në emër të Qeverisë, para deputetëve të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI FATMIR LIMAJ: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë.

Ligji për hekurudhat e Kosovës është një ndër ligjet në kuadër të ndërtimit të kuadrit ligjor në fushën e transportit hekurudhor, mjaft me rëndësi për zhvillimin e këtij sektori, deri më tash i lënë anash. Ky ligj rregullon këtë sferë dhe parashikon themelimin e autoriteteve rregullativ të hekurudhave.

Ky mekanizëm deri më tash nuk ka qenë fare i themeluar, i cili do të ndikonte drejtpërdrejt në liberalizimin e tregut të transportit hekurudhor dhe do të zhvillojë konkurrencën me qëllim të ofrimit të shërbimeve më cilësore për qytetarët e Republikës.

Kompetencat, përgjithësitë, struktura dhe mënyra e funksionimit të këtij autoriteti janë të precizuara në këtë ligj.

Autoriteti ka kompetencën që të lëshojë licenca dhe certifikata të sigurisë për operatorët e hekurudhave, si dhe të rregullojë, të mbikëqyrë dhe të zhvillojë përmes politikave praktika më të mira ndërkombëtare dhe evropiane në sektorin e hekurudhave.

Ky ligj ka paraparë edhe themelimin e Menaxherit të Infrastrukturës Hekurudhore, si ndërmarrje e veçantë, me qëllim të menaxhimit më efikas në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Autoriteti Rregullativ Hekurudhor do të udhëhiqet nga një bord ekzekutiv prej 4 anëtarësh, të cilët i zgjedh Kuvendi i Republikës së Kosovës pas propozimit të Qeverisë së Kosovës.

Bordi për punën e vetë do t'i raportojë Qeverisë dhe Kuvendit. Është e rëndësishme se me këtë ligj Qeveria e Republikës së Kosovës do t'i marrë kompetencat në këtë fushë që deri më tani nuk i ka pasur.

Ligji hap rrugë për zhvillimin e këtij sektori dhe ndikon në zhvillimin ekonomik të vendit dhe integrimin e transportit hekurudhor të Republikës së Kosovës në rajon dhe në BE.

Gjithashtu, stimulon politikat zhvillimore të Ministrisë së Transportit që tani e tutje transporti hekurudhor do të jetë një nga linjat kryesore të bartjes, sidomos, do të jetë një impuls i fuqishëm i zhvillimit ekonomik, në njërën anë dhe në anën tjetër, do të krijojë siguri dhe ruajtje më të qëndrueshme të rrjetit rrugor.

Me vendimet dhe strategjitë e Qeverisë në të ardhmen ky sektor do të marrë përfundimisht rrugën e zhvillimit dhe modernizimit të kësaj sfere. Ne besojmë se edhe Konferenca e Donatorëve do të jetë një nga mundësit, ku praktikisht edhe ky rrjet edhe ky segment tepër i rëndësishëm i transportit në Kosovë, do të rregullohet dhe të fillojë të funksionojë normalisht, që do ta ndihmonte ekonominë e vendit tonë. Prandaj, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj.

KRYETARI: Faleminderit!

Për fjalë është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit!

Jo me dashje kryetar, por faleminderit për fjalën.

Zoti ministër Limaj, Grupi Parlamentar i LDK-së do ta shqyrtojë me kujdes të veçantë këtë projektligj, sigurisht, që në parim e kemi mbështetjen për miratim.

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetarët e grupeve parlamentare nuk e kanë kërkuar fjalën.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Lexoni mocionin.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 votë “për”, 2 “kundër” 1 abstenim, miratohet Projektligji për hekurudhat e Kosovës.

Edhe një herë ju them, lexoni mocionin.

Në bazë të vendimit të datës 15 shkurt 2008, ngarkohet Komisioni ad-hoc, që për seancën e radhës t’ia paraqesë Kuvendit raportin me rekomandime.

Të nderuar deputetë,

Me kaq seancën e deklaroj të mbyllur.

Mirupafshim!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve